



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

_____г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 2 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga parashtrues i njohur KSHPK (në tekstin e mëtejshëm) në seancën e 73-të, të mbajtur më 18.08.2022, morri vendimin vijues:

VENDIM

Denoncimi me numër 12-4515/1 i datës 04.05.2022, HIDHET POSHT.

KSHPK-ja konstatoi se autoriteti kompetent për trajtimin e denoncimit është Këshilli Gjyqësor i RMV-së.

Parashtruesi ta përcjellë denoncimin për veprim kompetent në Këshillin Gjyqësor të RMV-së.

Lënda me numër 12-4515 të vitit 2022 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i KSHPK-së, në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

Arsyetim

Lënda me numër 12-4515/1 të datës 04.05.2022 është formuar në bazë të denoncimit të marrë nga ///. Në denoncim, parashtruesi paraqet pretendime në lidhje me dyshimet për kryerje të pakujdesshme të funksionit gjyqësor nga ///, nga /// dhe ///, si dhe nga përmbartuesi për fushën e caktuar gjyqësor, personi zyrtarë ///, dhe në lidhje me lëndën///, ku paditës është parashtruesi. Pretendimet i referohen ndikimit të kundërligjshëm në veprimet e zyrtarëve të përshkruar më parë për kontestin e cekur. Nga KSHPK-ja kërkohet ta rishqyrtojë këtë rast në përputhje me kompetencat e saj ligjore. Në shtojcë të denoncimit, nuk u dorëzuan prova.

Pas shqyrtimit të përmbajtjes së denoncimit, KSHPK-ja konstatoi se në këtë rast denoncimi nuk përmban elemente për veprimin e tij kompetent. Autoriteti kompetent që është i autorizuar për shqyrtimin e pretendimeve nga denoncimi është Këshilli Gjyqësor i RMV-së, për çka KSHPK-ja parashtruesi duhet t'ia përcjellë kërkesën për veprim kompetent këtij autoriteti.

Sipas sa më sipër, KSHPK-ja vendosi si në dispozitë të këtij vendimi.

Dorëzuar deri te:
Parashtruesi i denoncimit

Përgaditi: Mr D. D.
Miratoi: G.T.

Biljana Ivanovska

KOMISIONI SHTETËRORË
PËR PARANDALIMIN E KORRUPTIONIT
KRYETARE,

